



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr 50 Datë.24/12/2025

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT
PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2026, Vendimit të Këshillit të Qarkut “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2026-2028 për Këshillin e Qarkut”, VKM nr. 673 dt. 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publike”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026 si më poshtë:

<i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut gjithsej</i>		<i>222.8 milion lekë</i>
Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	85.8 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	20.4 milion lekë
	- Të ardhurat nga Financimi i huaj	18.5 milion leke
	- Të ardhura të trashëguara nga viti 2024	98.1 milion lekë
	- Transferta e kushtëzuar	
<i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut gjithsej</i>		<i>222.8 milion lekë</i>
Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	43.3 milion lekë
	- Për shpërblimin e anëtarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.5 milion lekë
	- Për investime nga Këshilli i Qarkut	122.5 milion lekë
	- Shpenzime korrente për realizimin e projekteve të ndryshme të planifikuara	38.1 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Korçë për qendrën Infopoint	3 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Kolonjë për pajisje për qendrën Infopoint	1.2 milion lekë
	- Kontribut bashkia Korçë për vazhdimin e Rezidencës Artistike	2 milion lekë
	- Aktivitete kulturore lokale në bashkëpunim me Bashkitë	3 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Korçë për projektin e artizanatit	4 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Pogradec për pajisjen me kondicionerë të Muzeut Historik	0.4 milion lekë
	- Kontribut Bashkia Kolonjë për projekt studimin e Muzeut të Sazeve në Leskovik	1.5 milion lekë
	- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë	0.2 milion lekë
	- Projekti STEP	0.1 milion lekë
	- Për fond rezervë	2 milion lekë

2. Të miratojë nivelin e tarifave të shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut për komunitetin në funksion të realizimit të detyrave të tij mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas pasqyrës bashkangjitur.
3. Të miratojë limitin e përdorimit të karburantit për automjetet e Këshillit të Qarkut deri në 1000 litra në muaj, por brenda fondit limit për blerje karburanti të miratuar për vitin 2026.
4. Të miratojë limitin e përdorimit telefonisë celulare për vitin 2026 brenda masës 2% të shpenzimeve për mallra dhe shërbime si më poshtë:
- Kryetar i Këshillit të Qarkut limiti mujor 4000 lekë
5. Të miratojë të gjitha pasqyrat e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026, buxhetin e përgjithshëm, pasqyrat e detajimit të buxhetit në aktivitete apo detajimit mujor, si dhe pasqyrat e nxjerra nga sistemi SMBV, të cilat i bashkangjiten këtij vendimi.
6. Në rast të lindjes të nevojës për ndryshime në buxhet dhe rishpërndarje te fondeve buxhetore, do të zbatohet neni 44, paragrafi i dytë, pikat a,b,c dhe ç të ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i cili citon se: *Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi: a) rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njesisë së qeverisjes vendore; b) rishpërndarjet e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njesisë së qeverisjes vendore; c) rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njesisë së qeverisjes vendore; ç) rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njesisë së qeverisjes vendore, nga e cila varet njësia shpenzuese.*
7. Projektet e investimeve në bashkepunim me bashkitë(raporti 60% me 40%) do të fillojnë të zbatohen vetëm pasi Bashkia përkatëse të ketë derdhur pjesën e saj takuese të fondit si kontribut për Këshillin e Qarkut.
8. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut të nënshkruajë marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë apo institucionet e tjera shtetërore, për çdo rast të dhënies të kontributeve financiare(604) të planifikuara në buxhetin e vitit 2026.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës dhe buxhetit, Sektori juridik, burimeve njerëzore dhe shërbimeve, Sektori i projekteve të zhvillimit, si dhe e gjithë administrata e Këshillit të Qarkut dhe Dega e Thesarit Korçë.
10. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2026.

Miratuar me	19 / Vota
Vota Pro	19 / Vota
Vota Kundër	0 / Vota
Vota Abstenim	0 / Vota
Zbardhur më datë	24/12/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2026

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, administrata e Këshillit të Qarkut ka punuar për hartimin e shifrave të buxhetit për vitin 2026.

Për hartimin e buxhetit jemi mbështetur në:

- Programi buxhetor afatmesëm 2026-2028 të miratuar nga Këshilli i Qarkut.
- Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2025 për periudhën 8/mujore.
- Analiza financiare e realizimit të pritshëm të treguesve ekonomike për vitin 2025.
- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Programi i aktiviteteve për vitin 2026 për institucionin e Këshillit të Qarkut të lidhura këto me objektivat e zhvillimit të qeverisjes qëndrore.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore dhe nënligjore.

Gjithashtu hartimi i buxhetit për vitin 2026 është bërë bazuar në konsultimet publike të realizuara gjatë muajve Tetor dhe Nëntor si dhe kërkesat e ardhura në drejtin të Qarkut nga institucionet e pushtetit vendor dhe jo vetëm.

➤ **Hartimi i buxhetit për vitin 2026**

Hartimi i buxhetit për vitin 2026 është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe akteve të tjera ligjore.

Gjithashtu hartimi i buxhetit për vitin 2026 është parë ngushtë lidhur edhe me problematikat e hasura gjatë vitit 2025. **Planifikimi i cdo zëri të buxhetit është bërë për të qënë sa më eficient dhe i realizueshëm, me qëllim që gjatë vitit 2026 të kemi mundësi të financojmë buxhetin e këtij viti, të mbyllim pjesën e borxhit të trashëguar dhe të mos krijojmë detyrime të reja.** Për të aritur këtë rezultat duhet një punë me përgjegjshmëri nga i gjithë stafi i administratës së Këshillit të Qarkut. Gjithashtu kërkojmë përgjegjësi nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Qarkut për realizimin e kontributit financiar të bashkive për këshillin e qarkut si detyrim ligjor për organet vendore të nivelit të dytë.

Planifikimi i të ardhurave

Për vitin 2026 buxheti total për Këshillin e Qarkut është planifikuar në vlerë 222.8 milion leke (duke mos e përfshirë transfertën e kushtëzuar të DAMT-së dhe transfertën e kushtëzuar të fondit social) duke synuar për të patur një buxhet sa më real dhe të mbuluar me fonde të realizueshme, përfshirë këtu edhe fondet nga financimi I huaj që presim të arkëtojmë si parafinancim për 2 projekte të huaja. Në vitin 2026, Këshilli i Qarkut Korçë do të fillojë zbatimin e 2 projekteve me financim të huaj. GST GERA dhe HEALTH4ALL. Mënyra e zbatimit të këtyre projekteve do të jetë, ashtu si dhe më përpara, me rimbursim shpenzimesh, që do të thotë se pala e huaj bën disbursimin e fondeve pas realizimit të shpenzimeve paraprakisht nga fondet tona buxhetore. Vetëm pjesa e parafinancimit (me kapitull 2) është planifikuar që ti shtohet buxhetit të vitit 2026 që në këtë moment. Rimbursimet do të shtohen në momentin që do të disbursohen.

Të ardhurat si burim i financimit të shpenzimeve janë planifikuar mbi bazën e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet e ardhura kryesore e buxhetit për organin vendor. **Per vitin 2026 Granti është celur në masën 85.8 milion lekë, me një rritje nga viti 2025 prej rreth 3 milion lekë. Nga 85.8 milion lekë, 7 milion është transfertë e pakushtëzuar sektoriale për pagat.**

Në planifikimin e të ardhurave janë mbajtur parasysh aktet ligjore në fuqi si dhe realizimi i tyre në periudhat e mëparshme. **Të ardhurat e veta në total janë planifikuar në masën 20.4 milion lekë.**

Në planin e të ardhurave peshën kryesore e kapin të ardhurat nga kontributi financiar i bashkive përbërëse të Këshillit të Qarkut. Kjo e ardhur është **planifikuar mbështetur në Ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” neni 38, pika 3, ku citohet shprehimisht se kuota e anëtarësisë të bashkive përbërëse për financimin e buxhetit të qarkut percaktohet me vendim të këshillit bashkiak. Kjo rit përgjegjesinë e Bashkive për të planifikuar dhe derdhur në kohë këtë detyrim.** Kjo e ardhur në vitet e kaluara është realizuar në nivele të ulta duke krijuar deficite të ndjeshme në buxhetin e këshillit të qarkut dhe kjo për arsye që janë trajtuar shumë herë. Për vitin 2026 ky kontribut është planifikuar në nivelin 20 milion lekë. Një vlerë kjo më e ulët se viti 2025, pasi në vitin 2025 kishim parashikuar të arkëtonim edhe kontributet e mbetura nga viti 2024. Edhe për vitin 2025, realizimi nga ky zë të ardhurash nuk ishte I kënaqshëm. Edhe pse ligji e citon se Bashkitë duhet të planifikojnë në buxhetet e tyre kontribute për Qarkun, Bashkitë nuk e bëjnë këtë gjë. U mendua nga grupi i punës se e vetmja mënyrë për ritur arkëtimin e të ardhurave nga ky zë, do të ishte planifikimi i investimeve apo finacimeve nga ana e Këshillit të Qarkut për bashkitë, në një raport 60%

me 40%. Që do të thotë se Qarku do i mbështesë Bashkitë me 60% të vlerës të investimit që ata do të kërkojnë, me kushtin që 40% të vlerës të këtij financimi, ta derdhin për llogari të Qarkut. Në këtë mënyrë edhe Qarku realizon të ardhurat edhe Bashkitë përfitojnë financime.

Në varësi të kontributit që Bashkitë do të japin për Këshillin e Qarkut, do të jetë edhe mbështetja financiare e Këshillit të Qarkut për projekte të ndryshme investimi apo studimi.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut, janë planifikuar në të njëjtat nivele si dhe viti 2025, në vlerë 430 mijë lekë, pavaresisht se realizimi i pritshëm i tyre është në nivele të ulta. Në këtë planifikim është marrë parasysh ecuria e këtyre të ardhurave në disa vite, meqenese nuk mund të bëhen llogaritje të sakta. Në këtë zë futen kryesisht të ardhurat nga tarifat e kadastrës dhe urbanistikes. Këshilli I Qarkut nuk ofron më shërbime në fushën e transportit pasi ato janë kompetencë e vetë bashkive. Arkëtimet nga këto tarifa janë në rënie dhe për këtë arsye nuk mund të planifikojmë më shumë të ardhura nga ky zë.

Gjithashtu për vitin 2026 janë marrë në konsideratë përdorimi i të ardhurave të papërdorura deri tani në vlerë 98.1 milion lekë. Kjo është vetëm një pjesë e trashëgimit të vitit 2025, pasi pjesa tjetër do ti shtohet buxhetit pas rakordimit me thesarin i cili bëhet zakonisht në muajin Janar. Nga vlera prej 98.1 milion lek trashëgim, 51.6 milion lekë janë nga rimbursimet e shpenzimeve të projekteve të huaja cilat janë mbyllur që në vitin 2023. Të gjitha fondet e mbetura të projekteve të huaja, në bankën e nivelit të dytë të dedikuar për projektin, u kaluan në thesar si rimbursim shpenzimesh duke qënë se këto shpenzime ishin kryer paraprakisht nga fondet buxhetore. Është kjo arsyeja që trashëgimi për vitin 2026 është në nivele të larta. Gjithashtu, duke qënë se këtë vit Këshilli i Qarkut do të fillojë zbatimin edhe të 2 projekteve të huaja të reja, është e rëndësishme që një pjesë e konsiderueshme e buxhetit (nga trashëgimi)ti dedikohet pikërisht realizimit të këtyre projekteve, sepse fondet nga pala e huaj vijnë pas realizimit paraprakisht të shpenzimeve nga njësia zbatuese e projektit.

Për vitin 2026, Këshilli i Qarkut ka planifikuar ti shtohen buxhetit dhe 18.5 milion lekë nga financimet e huaja, konkretisht nga parafinancimet për 2 projektet e huaja të sipërpërmendura. Këto fonde planifikohen me kapitull 2, që do të thotë se janë financim i huaj të dedikuara për projektet e huaja.

Bashkangjitur është pasqyra e tarifave që aplikon Këshilli i Qarkut për shërbimet që i ofron komunitetit, të miratuara këto me akte ligjore e nënligjore, si dhe pasqyra e llogaritjeve analitike të të ardhurave të parashikuara për vitin 2026.

Në total të ardhurat do të përdoren për financimin e funksioneve të veta të Këshillit të qarkut të miratuara me ligj.

Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat janë si më poshtë:

Granti: 85 760 094 lekë

Trashëgimi: 98 075 160 lekë

Të ardhurat e veta : 20 430 000 lekë

Financim I huaj: 18 500 000 lekë

Totali : 222 765 254 lekë
Nuk është pjesë e këtij buxheti transferta e kushtëzuar.

Planifikimi i shpenzimeve

Pjesë e rëndësishme e planit të buxhetit është planifikimi i shpenzimeve . Nga ana Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e menaxhimit të programeve, planifikimi i shpenzimeve është parë me kujdes në çdo element të tij mbi bazën e zbatimit të Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit si dhe të realizimit të buxhetit për vitin 2026, si dhe mbështetur në miratimin paraprak të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028. Grupi i punës ka bërë parashikimin e buxhetit për vitin 2026 mbi bazën e metodologjisë të re të buxhetimit, programeve, funksioneve dhe produkteve, si dhe aktivitetëve të miratuara. Sipas kësaj metodologjie, Këshilli i Qarkut do të ketë 1 program të vetëm buxhetor dhe aktivitetet do të jenë të organizuara në produktet standarte sipas funksioneve përkatëse, sipas shtojcës nr 5 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 dt.28.02.2025

Në total buxheti për vitin 2026 është planifikuar në vlerën 222.8 milion lekë me burim financimi transfertën e pakushtëzuar me vlerë 85.8 milion lekë, të ardhurat e institucionit për vitin 2026 dhe trashëgimi nga viti 2025 me vlerë 118.5 milion leke, si dhe parashikimi për të ardhurat nga financimi i huaj, 18.5 milion lekë. Transferta e pakushtëzuar vazhdon të mbetet një burim i rëndësishëm i financimit të shpenzimeve për Këshillin e Qarkut. Bashkangjitur materialit është tabela analitike e llogaritjes të shpenzimeve të buxhetit.

Planifikimi i shpenzimeve të personelit

Në zbatim të Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” numri i punonjësve të stafit të administratës të Këshillit të Qarkut është 13 punonjës dhe 3 titullarë të zgjedhur dhe të emëruar. Në këto kushte planifikimi i fondit të pagave është bërë sipas strukturës ekzistuese, e cila u ndryshua në vitin 2025, bazuar në Ligjin e Buxhetit të vitit 2025. Për këtë arsye niveli i pagave ka pësuar një rritje krahasuar me vitin 2024. Gjithashtu edhe një rritje të vogël krahasuar me vitin 2025. Pasi është planifikuar dhe një fond 3% shtesë mbi fondin e pagave, nëse do të ketë një indeksim të pagave sipas inflacionit. Në zbatim të VKM-së nr 503 dt 01.08.2024 **Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”** dhe ndryshimit në numrin e punonjësve, fondi i pagave është llogaritur mbi bazën e këtyre të dhënave. Në vlerë pagat e sigurimet shoqërore për vitin 2026 janë 34 milion lekë dhe kapin 15 % të totalit të shpenzimeve. Brenda këtij fondi është llogaritur edhe transferta a pakushtëzuar specifike për pagat si dhe fondi i vecante 5% i cili llogaritet mbi vlerën e fondit të pagave. Financimi i tyre është parashikuar me fonde nga transferta e pakushtëzuar, një pjesë shumë e vogël nga trashëgimi, si dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale që ka erdhur specifikisht për pagat.

Në buxhetin e vitit 2026 është planifikuar edhe financimi i shpërblimit për anëtarët e kryesisë të Këshillit të Qarkut sipas vendimit përkatës në vlerë 1.6 milion lekë, 10% e pagës të Kryetarit.

- **Planifikimi i shpenzimeve operative për administratën e Këshillit të Qarkut**

Planifikimi i shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera për vitin 2026 për administratën është bërë sipas klasifikimit ekonomik për çdo funksion në vecanti, te organizuara në produkte sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.8 dt.28.02.2025. **Planifikimi i shpenzimeve operative për vitin 2026 për funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut është në nivelin 9.4 milion lekë ku është parashikuar edhe financimi i borxhit të trashëguar.** Financimi i shpenzimeve operative do të bëhet kryesisht me fonde nga transfertat e pakushtëzuar. Niveli i këtyre shpenzimeve kap rreth 4.2 % të totalit.

Niveli i shpenzimeve është planifikuar mbi bazën e normativave të miratuara me akte ligjore për disa zëra shpenzimesh. Niveli i planifikuar i shpenzimeve mbulon aktivitetin e administratës së këshillit të qarkut në përmbushje të misionit të tij. Shpenzimet operative të administratës janë të detajuara në aktivitete sipas tabelës të buxhetit të përgjithshëm, bashkëngjitur këtij materiali.

Shpenzimet për vendimet gjyqësore janë parashikuar nga trashëgimi, pasi lidhen me pagesën e një tarife përmbartimi 20400 lekë, Këshilli I Qarkut nuk ka vendime gjyqësore të planifikuara për 2026.

Brenda këtij zeri kemi llogaritur edhe Fondin Rezervë për vitin 2026 në masën 2 milion lekë.

Gjithashtu Këshilli I Qarkut ka planifikuar edhe shpenzime të tjera operative që lidhen me funksione të tjera shpenzimesh.

Funksioni 04760 : Turizmi. Totali i shpenzimeve operative për këtë funksion është 7.15 milion lekë ose 3.2% të totalit të shpenzimeve. Disa prej zërave kryesorë të shpenzimeve që i përkasin këtij funksioni janë:

1,500,000	Prezantimi i produktit turistik rajonal në panairë ndërkombetare (Philoxenia)
700,000	Shpenzime për promovimin e atraksioneve turistike të qarkut
750,000	Organizim dhe mbështetje për të rinjtë në turizëm. 20 guida turistike (katering dhe organizimi i eventit)
3,000,000	Kontribut Bashkia Korce për qendrën infopoint
1,200,000	Kontribut Bashkia Kolonje për pajisje për qendrën infopoint

Funksioni 10140: Kujdesi social. Totali I shpenzimeve operative për këtë program është 6.2 milion lekë ose 2.8% e totalit.

5,000,000	Projekte sociale me bashkte e qarkut, moshat e trata dhe femijet e komuniteteve
500,000	te verberit
150,000	Qendra rezidenciale e zhvillimit Korce
500,000	(Aktiviteti tetori roze)

Theksojmë se në projektet sociale kemi dhe projektin HEALTH4ALL, projekt me financim të huaj të cilit i kemi dedikuar fonde për shpenzime operative nga buxheti tonë për financimin e shpenzimeve pasi fondet nga pala e huaj do të disbursohen pas certifikimit të këtyre shpenzimeve.

Funksioni 09230: Arsimi i mesëm. Totali i shpenzimeve operative për këtë funksion është 1.6 milion lekë ose rreth 1% e totalit të buxhetit.

Funksioni 04220: Bujqësia. Këtu është parashikuar një fond prej 700 mijë lekësh për promovimin e produkteve bujqësore dhe fermerëve të Rajonit.

Funksioni 04570: Transporti publik. Ky funksion lidhet në fakt me projektin e huaj GST GERA. Edhe këtu kemi planifikuar një fond për shpenzime operative, që njëlloj si dhe për projektin HEALTH4ALL, do të shërbejë për financimin paraprak të këtyre shpenzimeve, dhe më pas fondet do të rimbursohen nga pala e huaj.

Funksioni 08220: Trashëgimia kulturore, arti dhe kultura. Totali i shpenzimeve operative të këtij funksioni është 22.2 milion lekë ose 9.9% e totalit të buxhetit.

120,000	Konkursi me nxenesit e shkollave, gjuha ime
120,000	Konkursi me nxenesit e shkollave, liceeseistet
120,000	Konkursi me nxenesit e shkollave, historianet
120,000	Blerje materiale per shkollen e muzikes Tefta Tashko Koco
240,000	Transport per 2 aktivitete te nxenesve te shkolles Tefta Tashko Koco
500,000	Festivali I shkollave te mesme te muzikes
120,000	Koncert me sopranon rumune
120,000	Event ne nderim te telekronistev e gazetareve sportive te Qarkut
2,000,000	Kontribut bashkia Korce per vazhdimin e rezidences artistike

2,000,000	Rin-Art Qarku Korce
120,000	Ekspozita e fotografeve te njohur te qarkut
3,500,000	Autonom fest
1,000,000	Sherbim, dokumentar "Krahina Autonome e Korces 110 vjetori"
120,000	Ekspozita e koleksionistev e "Krahina autonome e Korces"
700,000	Projekti FOLKID
1,400,000	Smart projekt idete
1,000,000	Mirembajtje I monumenteve te ushtarit te panjohur dhe Naim Frasherit

3,000,000	Aktivite kulturore lokale ne bashkepunim me Bashkite
4,000,000	Kontribut Bashkia Korce per projektin e artizanatit
390,000	Kontribut Bashkia Pogradec per pajisjen me kondicionere te muzeut historik
1,500,000	Kontribut Bashkia Kolonje per projekt studimin e Muzeut te Sazeve ne Leskovik

Të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura do të organizohen në produkte me kodet përkatëse sipas kërkesave të udhëzimeve të Ministrisë të Financave, në zbatim të metodologjisë të re të hartimit të buxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

Për vitin 2026 janë planifikuar produktet si më poshtë:

-Shërbimi i stafit të administrim dhe menaxhim (01110) V111AAA, -Mirëmbajtja e infrastrukturës dhe funksionimi i aparatit (01110) V111AAD, -Akte të miratuara nga Këshilli (01110) V111AAB, -Përbushja e detyrimeve gjyqësore (01110) V111AAG -Nëpunës të trajnuar (01110) V111AAH, -Fondi rezerve V491AAA, -Promovimi i turizmit V476AAB, -Plani Strategjik i zhvillimit V413AAA, -Fermë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor V422AAD, -Promovimi i trashëgimisë kulturore (08220) V822AAD, -Objekte të trashëgimisë Kulturore të mirëmbajtura V822AAC, -Objekte të arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale V923AAB, -Shërbim transporti publik V457AAA, -Individë AK që përfitojnë trajtim V014AAE, -Persona që përfitojnë kujdesin social V014AAB

Këshilli i Qarkut është përpjekur ti prekë të gjithë sektorët prioritarë të Rajonit tonë si: turizmi, arti dhe kultura, trashëgimia kulturore, bujqësia etj, duke alokuar fonde sipas kapaciteteve të saj financiare, për realizimin e aktiviteve të ndryshme. Një Pjesë e këtyre aktiviteve janë parashikuar edhe në formën e kontributeve direkte për Bashkitë, pasi Qarku ka kapacitete të kufizuara në burime njerëzore dhe e ka të pamundur realizimin e të gjitha kërkesave të bashkive. Në këto kushte për të lehtësuar procesin, bazuar në kërkesat e bashkive dhe dokumentacionet e dorëzuara prej tyre, lidhen marrëveshjet e bashkëpunimit me destinacion midis Qarkut dhe Bashkisë përkatëse për realizimin e secilit kontribut të planifikuar.

Planifikimi i Investimeve

Për vitin 2026 janë planifikuar rreth 122.5 milion lekë investime ose 55 % të totalit të buxhetit. Brenda kësaj vlere të llogarisë 230 dhe 231, janë planifikuar edhe shpenzimet për investime kapitale për projektet e huaja. Konkretisht:

GST GERA: 11.3 milion lekë

HEALTH4ALL: 20 milion lekë

Pra rreth 25.5% të fondit të investimeve i zenë investimet që parashikohen të realizohen për projektet me financim të huaj. Nga i gjithë fondi i lënë për investime për projektet e huaja, 18.5 milion lekë janë me burim financimi kapitull 2, pra nga fondet që pritet të vijnë nga pala e huaj për parafinancimet e projekteve.

Zërat e investimeve janë si më poshtë:

1,200,000	Studim projektim per ndertesen e Keshillit te Qarkut
120,000	pajisje transmetimi digjital per institucionin
500,000	Investime, blerje pajisje per ngrohje
430,000	Blerje pajisje per DAMT
1,000,000	Blerje pajisje per zyrat e institucionit
120,000	Blerje grila/perde per institucionin
120,000	Blerje rafta per arkivin
600,000	Instalime dhe pajisje per mbrojtjen nga zjarri
1,000,000	Riparime ne objekt dhe mirembajtje
4,930,000	Ristrukturim I hollit te katit te pare te godines te Qarkut
80,300	Mbikqyrje riskstrukturim hollit

9,700	Kolaudim ristrukturim I hollit
6,000,000	Tabela promocionale elektronike per promovimin e turizmit ne Qark
1,453,742	Sinjalistike turistike
50,000,000	Investime ne bashkepunim me bashkite (60%+40%) per vitin 2026
7,759,278	Ndertimi i Muzeut Dritero Agolli vazhdim
535,000	Mbikqyrje ndertimi i Muzeut Dritero Agolli
65,000	Kolaudim ndertimi i Muzeut Dritero Agolli
12,000,000	Krijimi I i muzeut etnografik dhe historik ne Bashkine Korce
1,500,000	Kthimi I monumentit te Themistokli Germenjt ne identitet
1,700,000	Pajisje per modernizimin digjital te shkollave
22000	Mbikqyrje objekti bashkia Erseke

Peshën më të madhe të investimeve e zenë investimet në bashkëpunim me bashkitë 60% me 40%. Vlera e këtij zëri është përlogaritur 50 milion lekë nga të cilat 30 milion lekë do të jenë fonde të Qarkut dhe 20 milion lekë nga kontributet e bashkive. Detajimi i këtij zëri do të bëhet në një moment të dytë pasi të shqyrtohen edhe kërkesat e bashkive për investime.

Realizimi i këtyre investimeve do të varet edhe nga kontributet e bashkive për llogari të Qarkut.

Gjithashtu një vlerë të konsiderueshme ze edhe Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli, i cili ka nisur që në vitin 2025 por nuk ka përfunduar Akoma financimi i tij.

• **Planifikimi i bashkëfinancimit në Projektet e BE**

Për vitin 2026 Këshilli i Qarkut ka alokuar fonde për shpenzime operative dhe për shpenzime kapitale, nga buxheti i tij, për 2 projektet me financim të huaj, GST GERA dhe HEALTH4ALL. Fondet e alokuara për këto projekte të huaja janë me burim financimi nga trashëgimi i vitit 2025 i fondeve që erdhën si rimbursime shpenzimesh për projektet e huaja të përfunduara dhe me burim financimi nga kapitulli 2 , pra nga parafinancimet që pritet të vijnë për projektet e reja.

Vlera totale e projektit GST GERA është 555 mijë euro

Vlera totale e projektit HEALTH4ALL është 358 mijë euro

Konkretisht fondi i alokuar për projektet me financim të huaj është 45.2 milion lekë dhe ze rreth 20.3% të buxhetit. Nga 45.2 milion lekë, 26.7 milion lekë janë planifikuar nga trashëgimi dhe 18.5 milion lekë nga financimi i huaj me kapitull 2. Projektet me financim të huaj financohen 85 % nga pala e huaj dhe fondet për shpenzime disbursohen pas realizimit të shpenzimeve paraprakisht nga fondet tona. Pas certifikimit të shpenzimeve nga pala e huaj ato disbursohen në formën e rimbursimit të shpenzimeve dhe behen pjesë e buxhetit sipas vendimeve të Këshillit.

Pra është domosdoshmëri që institucioni zbatues i projekteve të planifikojë fonde nga të vetat për fillimin e zbatimit të projekteve të huaja për të mos penguar punën për fillimin e projekteve si dhe për të financuar pjesën takuese prej 15 % apo edhe vlerat e TVSH-së e cila nuk financohet nga BE-ja

Keshilli i qarkut po vazhdon punën për pjesëmarrje në thirje të reja të celura nga Bashkimi European në bashkëpunim me partnere rajonale e ndërkombëtarë. Kjo do të bëjë të mundur vazhdimësinë e pjesëmarrjes në keto Programe, të cilat do të sjellin një stad të ri të zhvillimit të rajonit.

Për vitin 2026 nuk janë marrë parasysh në buxhet transfertat e kushtëzuara të DAMT-së dhe planit social.

Në total përqindjet e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike ndaj totali të buxhetit janë si më poshtë:

Paga dhe sigurime	15.3%
Shpenzimet operative 602	22%
Shpenzime korrente 604	6.8%
Investimet	55%
Fondi rezerve	1%

Ky është një buxhet që vjen i miratuar me Ligjin e Buxhetit.

Keto ishin zërat kryesore të Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026.

Bashkangjitur këtij material janë pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave, pasqyra e shpenzimeve sipas aktiviteteve, funksioneve dhe llogarive ekonomike si dhe pasqyra e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2026.

Korçë, më 12.12.2025

Përgjegjëse Finance
Oljona Beqiraj

EMP-të
Mimoza Shuli
Mariela Alickolli
Elona Mano
Paola Lara
Doriana Tego
Mirela Shkurti
Flodi Mero
Niko Janaqi

KRYETARI
Petrika Tollkuçi

